

VENDIM
Nr. 1106, datë 29.12.2015

PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.
2. Efekti financiar për përballimin e këtij shpenzimi të mbulohet nga fondi i pagave, i planifikuar për vitin 2015, për programin buxhetor “Garda e Republikës”.
3. Masa e shpërblimit të jetë deri në 1 (një) pagë mujore.
4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama